



# GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



## Buletini Informativ

Korrik — Dhjetor 2021



## Kushtetuta e Kosovës - Kapitulli VIII

## Gjykata Kushtetuese

## Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

## PËRMBAJTJA:

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS .....2

VIZITAT DHE AKTIVITETET E GJYKATËS.....5

AKTGJYKIME .....12

GJEDNJ - VENDIME TË RËNDËSISHME .....18

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

## Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës emërohen në pajtim me nenin 114 [*Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, dhe të neneve 6 dhe 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 dhe në pajtim me nenin e mëparshëm 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) gjyqtarët u emëruan nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Kuvendit.

Nga 6 (gjashtë) gjyqtarët vendorë, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 6 (gjashtë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 9 (nëntë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes.

Në pajtim me nenin e lartpërmendur 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

\* Pas përfundimit të mandatit të Kryetares së Gjykatës Kushtetuese dhe dorëheqjes të një gjyqtari në muajin qershor, Gjykata aktualisht përbëhet nga 7 (shtatë) gjyqtarë.






## Statusi i lëndëve

Gjatë periudhës gjashtëmuajore: 1 korrik – 31 dhjetor 2021, Gjykata ka pranuar 115 kërkesa të reja, ndërsa ka pasur në punë gjithsej 270 kërkesa/lëndë.

Gjithsej 120 kërkesa janë zgjidhur ose 44.44% e të gjitha rasteve në dispozicion.

Gjatë kësaj periudhe, 115 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës.

*Dinamika e kërkesave të pranuar sipas muajve  
(1 korrik – 31 dhjetor 2021)*



Në vijim janë paraqitur 12 aktgjykimet që Gjykata nxori gjatë periudhës gjashtëmuajore, 1 korrik – 31 dhjetor 2021:

- Aktgjykim në rastin KI 175/19, parashtruar nga: Ismajl Zogaj. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit [KMLC. nr. 129/2019] të Prokurorit të Shtetit, të 13 gushtit 2019, aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës [Ac. nr. 3983/2018], të 24 majit 2019 dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë [C.nr. 118/2018], të 2 shkurtit 2018.
- Aktgjykim në rastin KI 01/20, parashtruar nga: Momir Marinković. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit [AC-I-17-0074-A123] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 8 tetorit 2019.
- Aktgjykim në rastin KI 82/21, parashtruar nga: Komuna e Gjakovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [UPP-APP. nr. 1/2020], të 28 tetorit 2020.
- Aktgjykim në rastin KO 61/21, parashtruar nga:

Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës [nr. 08/V-005], të 22 marsit 2021, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

- Aktgjykim në rastin KI 100/21, parashtruar nga: Moni Commerce sh.p.k. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [ARJ-UZVP.nr. 72/2020], të 28 tetorit 2020.
- Aktgjykim në rastin KI 01/21, parashtruar nga: Ajshe Aliu. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [ARJ-UZVP.nr. 37/2020], të 11 qershorit 2020.
- Aktgjykim në rastin KI 189/20, parashtruar nga: IPKO Telecommunications L.L.C. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [ARJ-UZPV.nr.17/2020], të datës 20 janar 2020.
- Aktgjykim në rastin KI 54/21, parashtruar nga: Kamber Hoxha. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 393/2020], të datës 1 shkurt 2021.
- Aktgjykim në rastin KI 43/21, parashtruar nga: Avdyl Bajgora. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. 558/2020], të datës 22 shkurt 2020.
- Aktgjykim në rastin KI 84/21, parashtruar nga: Telekom i Kosovës Sh.A. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, [CML.nr.12/20], të datës 20 janar 2021.
- Aktgjykim në rastin KO 127/21, parashtruar nga: Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 08-V-029] të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

- Aktgjykim në rastin KI 120/19, parashtruar nga: Mursel Gashi. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit [AC-I-17-0568], të 14 marsit 2019.

## Llojet e shkeljeve të pretenduara

Llojet e shkeljeve të pretenduara nga 115 kërkesat e pranuar gjatë periudhës gjashtëmuajore, 1 korrik – 31 dhjetor 2021, janë si në vijim:

- Neni 2 [Sovraniteti], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 3 [Barazia Para Ligjit], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 7 [Vlerat], 2 raste ose 1,7%;
- Neni 12 [Pushteti Lokal], 2 raste ose 3,3%;
- Neni 16 [Epërsia e Kushtetutës], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 21 [Parimet e Përgjithshme], 5 raste ose 2,6%;
- Neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 6 raste ose 3,1%;
- Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut], 4 raste ose 2,1%;
- Neni 24 [Barazia Para Ligjit], 19 raste ose 9,8 %;
- Neni 26 [E Drejta e Integritetit Personal], 2 raste ose 1%;
- Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 63 raste ose 32,6%;
- Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 11 raste ose 5,7%;
- Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 35 [Liria e Lëvizjes], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 3 raste ose 1,6%;
- Neni 46 [Mbrojtja e Pronës], 19 raste ose 9,8%;
- Neni 47 [E Drejta për Arsimin], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 48 [Liria e Artit dhe e Shkencës], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve], 7 raste ose 3,6%;
- Neni 50 [Të Drejtat e Fëmijës], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e


e Njeriut], 5 raste ose 2,6%;

- Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 14 raste ose 17,3%;
- Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], 4 raste ose 2,1%;
- Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 101 [Shërbimi Civil], 2 raste ose 1%;
- Shkelje të tjera, 8 raste ose 4,1%;

## Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 95 kërkesa ose 82,6% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave;
- 20 kërkesa ose 17,4% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e autoriteteve të tjera publike;

*Shkelësit e supozuar të të drejtave  
(1 korrik – 31 dhjetor 2021)*



## Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë periudhës gjashtëmuajore: 1 korrik – 31 dhjetor 2021, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 28 seanca plenare dhe 150 kolegje shqyrtuese, në të cilat rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime dhe vendime.


Gjatë kësaj periudhe, Gjykata Kushtetuese ka publikuar gjithsej 115 vendime.

Struktura e vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 12 Aktgjykime (10,4%);
- 84 Aktvendime për papranueshmëri (73%);
- 16 Vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër (13,9%);
- 1 Vendim për masë të përkohshme (1 %);
- 2 Aktvendime për mospërmbarim (1,7%);



*Struktura e vendimeve të publikuara  
(1 korrik – 31 dhjetor 2021)*




## Qasja në Gjykatë

Qasja e individëve në Gjykatë është si në vijim:

- 94 kërkesa nga shqiptarët, ose 81,7%;
- 4 kërkesa nga komuniteti serb, ose 3,5%;
- 2 kërkesa nga komunitetet e tjera, ose 1,7%;
- 15 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet e tjera publike (personat juridik), ose 13%;

*Struktura etnike e parashtruesve të kërkesave  
(1 korrik – 31 dhjetor 2021)*



**2 korrik 2021**

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim Avokatin e Popullit të Republikës së Turqisë, z. Şeref Malkoç, të shoqëruar nga ambasadori i Turqisë në Kosovë, z. Çağrı Sakar.

Pasi që e falënderoi për vizitën, kryetarja Caka – Nimani fillimisht e njoftoi z. Malkoç me punën e deritanishme të Gjykatës, me natyrën e kërkesave të parashtruara nga individët, me procesin e pranimit të kërkesave dhe të shqyrtimit të lëndëve në kushte pandemie, si dhe me zbatimin e vendimeve të Gjykatës nga autoritetet shtetërore.

Në vazhdim ajo vuri theksin në rolin e rëndësishëm që ka luajtur Gjykata Kushtetuese e Kosovës me vendimmarrjen e saj ndër vite, veçanërisht në mbrojtjen e kushtetutshmërisë në vend dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe për raportet e bashkëpunimit të shkëlqyer me shumë gjykata homologe në rajon dhe me gjerë, përfshirë këtu edhe Gjykatën Kushtetuese të Turqisë.

Nga ana e tij, pasi që i uroi suksese znj. Caka – Nimani në detyrën e saj të re si Kryetare e Gjykatës Kushtetuese, z. Malkoç shprehu vullnetin për shkëmbimin e përvojave reciproke dhe për bashkëpunim të ngushtë institucional në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

**5 korrik 2021**

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim Shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësuesin e Posaçëm të BE-së, z. Tomas Szunyog. Temë e diskutimit të përbashkët ndër të tjera ishin roli dhe

vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese në proceset e zhvillimit demokratik të vendit, rëndësia e zbatimit të vendimeve të gjykatave të çdo niveli, si dhe nevoja për të përvetësuar përvojën dhe praktikën më të mira të vendeve evropiane në lëmin e gjyqësisë kushtetuese.

Kryetarja Caka – Nimani në vijim shfrytëzoi rastin që t'i shpreh falënderimin dhe mirënjohjen z. Szunyog për përkrahjen e vazhdueshme që institucionet evropiane i ka dhënë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ndër vite, në konsolidimin e kapaciteteve të saj profesionale dhe infrastrukturore nëpërmjet realizimit të projekteve të përbashkëta.

Pasi që e përgëzoi znj. Caka – Nimani për zgjedhjen e saj në krye të Gjykatës Kushtetuese, z. Szunyog konfirmoi se ofrimi i asistencës për institucionet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit mbetet prioritet për Bashkimin Evropian.

**8 korrik 2021**

Në vazhdim të takimeve me udhëheqës institucional vendor dhe përfaqësues ndërkombëtar pas marrjes së detyrës së Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani u takua me kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca.



Në takim ndër të tjera u diskutua për vazhdimin e bashkëpunimit të mirë institucional ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Kuvendit të Kosovës, për sfidat në punën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe për avancimin e kornizës ligjore në funksion të konsolidimit të mëtejshëm të gjyqësisë kushtetuese në Republikën e Kosovës.



e Kosovës. Të dy kryetarët nënvizuan rëndësinë e respektimit të ndarjes së pushteteve, duke theksuar tutje domosdoshmërinë e bashkëveprimit institucional në mbrojtje të kushtetutshmërisë dhe forcimin e sundimit të ligjit në vend.

**12 korrik 2021**



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, z. Philip S. Kosnett. Pasi që e falënderoi për vizitën, kryetarja Caka – Nimani e njoftoi ambasadorin Kosnett me punën e deritanishme të Gjykatës, si dhe me prioritetet e saj gjatë mandatit tre vjeçar në krye të Gjykatës Kushtetuese.

Ajo shprehu mirënjohjen për përkrahjen që Qeveria amerikane i ka ofruar Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet projekteve të ndryshme për konsolidimin e saj institucional që nga themelimi dhe theksoi nevojën që kjo përkrahje të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Pasi që i uroi suksese znj. Caka – Nimani në detyrën e Kryetares së Gjykatës, ambasadori Kosnett u zotua për vazhdimin e mbështetjes së Shteteve të Bashkuara për Gjykatën Kushtetuese dhe për institucionet e tjera në vend, me qëllim të forcimit të gjyqësisë së pavarur dhe sundimit të së drejtës në Republikën e Kosovës.

**14 korrik 2021**



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim kryetarin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, z. Enver Peci.

Gjatë takimit, kryetarja Caka – Nimani dhe kryetari Peci diskutuan, ndër të tjera, për mundësitë e intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që ata udhëheqin, për sfidat e përbashkëta në përpjekjet për përmirësimin e komunikimit me publikun, si dhe për mundësitë e rritjes së transparencës në punën e të dy gjykatave.

Në vazhdim të bisedës, të dy kryetarët theksuan rëndësinë që ka mbrojtja e pavarësisë së pushtetit gjyqësor në funksion të forcimit të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

**15 korrik 2021**



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani priti në takim Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Albert Zogaj. Pas urimeve të ndërsjella për suksese në përmbushjen e detyrave në postet e tyre të reja, kryetarja Caka – Nimani dhe kryesuesi Zogaj përqendruan diskutimin në sfidat e sistemit gjyqësor të Kosovës, si dhe objektivat e rëndësisë parësore për forcimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë. Të dyja palët u pajtuan për nevojën e kultivimit të mëtutjeshëm të raporteve të mira të bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe për mundësitë e realizimit të aktiviteteve të përbashkëta profesionale me gjykatat e niveleve të tjera në vend.

**4 gusht 2021**

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim ambasadorin e Holandës në Kosovë, znj. Carin Lobbezoo.

Sfidat aktuale në punën e Gjykatës dhe prioritetet në



punën e Gjykatës dhe prioritetet në punë gjatë mandatit trevjeçar të kryetares Caka – Nimani, ishin vetëm disa ndër temat që u trajtuan në takimin e përbashkët. Kryetarja Caka – Nimani në vijim diskutoi edhe për angazhimin e vazhdueshëm të Gjykatës për avancimin dhe konsolidimin e praktikës gjyqësore të saj, si dhe për rritjen e standardeve të gjykimin dhe të cilësisë së vendimeve.

Ambasadorja Lobbzoo i uroi suksese kryetares Caka – Nimani në përmbushjen e detyrave të saj në krye të Gjykatës Kushtetuese dhe theksoi se, forcimi i sundimit të ligjit në Kosovë është edhe në interesin e qeverisë holandeze.



### 13 gusht 2021

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Qemal Minxhozi.

Pasi që i shprehu mirëseardhjen, kryetarja Caka – Nimani e njoftoi ambasadorin Minxhozi me punën e deritanishme të Gjykatës, me përpjekjet që po bëhen për rritjen e efikasitetit në punë dhe me zhvillimet e fundit në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës.



Ajo i vlerësoi si të shkëlqyera marrëdhëniet reciproke me Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë dhe konfirmoi gatishmërinë për intensifikimin e mëturjes së bashkëpunimit nëpërmjet projekteve të përbashkëta.

Ambasadori Minxhozi i shprehu urimet e tij znj. Caka – Nimani për marrjen e detyrës së Kryetares së Gjykatës Kushtetuese dhe theksoi se do të mbetet gjithnjë i përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

### 17 gusht 2021

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Nicholas Abbott.

Në takim ndër të tjera u diskutua për punën dhe për funksionimin e Gjykatës pas largimit të dy gjyqtarëve kushtetues në qershor të këtij viti, si dhe për rëndësinë e ruajtjes së pavarësisë funksionale të saj, si parakusht i domosdoshëm për mbrojtjen e kushtetutshmërisë në vend.



Kryetarja Caka – Nimani vuri theksin edhe në rëndësinë e rritjes së transparencës në punë, në avancimin e kapaciteteve profesionale dhe komunikimin më të mirë të Gjykatës me publikun, me ç'rast edhe shprehu mirënjohjen e saj për ndihmën që Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar i ka ofruar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në këtë drejtim.

Ambasadori Abbott, pasi që i uroi suksese kryetares Caka – Nimani në përmbushjen e obligimeve në detyrën e saj të re, nënvizoi rëndësinë e ruajtjes së integritetit institucional të Gjykatës Kushtetuese dhe u zotua për vazhdimin e përkrahjes edhe në të ardhmen.

### 13 shtator 2021

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, z. Frank Power. Në takimin e përbashkët ndër të tjera u diskutua për vazhdimin e mbështetjes që Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë i ka ofruar Gjykatës



Kushtetuese deri më tani, veçanërisht në trajnimet profesionale përkitazi me zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përafrimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës me atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kryetarja Caka – Nimani dhe z. Power në vazhdim shkëmbyen pikëpamjet e tyre edhe rreth objektivave të rëndësishme parësore për forcimin e gjyqësorit të pavarur në vend, duke vënë theksin në rëndësinë e përmirësimit të komunikimit me publikun dhe rritjen transparencës në punë.



### 30 shtator 2021

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, i udhëhequr nga kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, po qëndron në vizitë zyrtare dy ditore në Shqipëri.

Gjatë qëndrimit në Tiranë, kryetarja Caka – Nimani dhe homologia e saj shqiptare, znj. Vitore Tusha, nënshkruan dhe në një ceremoni solemne Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, me qëllim të vazhdimin të bashkëpunimit



të dy gjykatave për një periudhë të re pesëvjeçare, në fushat me interes të ndërsjellë.

Memorandumi i Bashkëpunimit, ndër të tjera, parasheh zhvillimin e programeve të bashkëpunimit

dypalësh me qëllim të përvetësimit të praktikave më të mira evropiane të së drejtës kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, forcimin e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe të stafit mbështetës, rritjen e cilësisë së vendimeve dhe përmirësimin e komunikimit me publikun.

Me përkrahjen e fondacionit gjerman “Hans Siedel Stiftung”, në vazhdim të vizitës në Shqipëri, gjyqtarët e të dy gjykatave kushtetuese sot morën pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë: “Mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore – praktikat respektive sipas jurisprudencës kushtetuese”.

25 tetor 2021



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim njohës Drejtoreshën e re të Misionit të USAID-it në Kosovë, znj. Zeinah Salahi.

Gjatë takimit, kryetarja Caka – Nimani e njoftoi në pika të shkurtra znj. Salahi me prioritetet në mandatin e saj si kryetare e Gjykatës Kushtetuese, me sfidat e përballura në punën e deritanishme dhe me përpjekjet që po bëhen për avancimin e kapaciteteve profesionale dhe infrastrukturore të Gjykatës me ndihmën edhe të donatorëve ndërkombëtarë.

Pasi që shprehu falënderimin e saj për Misionin e USAID-it në Kosovë për përkrahjen e ofruar Gjykatës Kushtetuese ndër vite, kryetarja Caka – Nimani në vazhdim bëri një prezantim më të detajuar rreth projekteve të përfshira në Planin e ri Strategjik të Gjykatës, me theks të posaçëm në konsolidimin e praktikës gjyqësore dhe të cilësisë së vendimeve me standardet evropiane, avancimin e sistemit elektronik për menaxhimin e rasteve dhe përmirësimin e komunikimit me publikun.

Znj. Salahi shprehu nga ana e saj zotimin për vazhdimin e përkrahjes së USAID-it ndaj Gjykatës Kushtetuese, si dhe për institucionet e tjera në vend,



në funksion të forcimit të sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

**9 nëntor 2021**



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim ambasadorin e Francës në Kosovë, znj. Marie-Christine Butel. Puna e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese, sfidat aktuale në funksionimin e saj dhe prioritetet në punë gjatë vitit të ardhshëm, ishin ndër temat e diskutuara në takimin e përbashkët.

Kryetarja Caka – Nimani në vazhdim e njoftoi ambasadorin Butel edhe me raportet e mira të bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave homologe në rajon dhe më gjerë, si dhe me përpjekjet e Gjykatës për anëtarësim në organizatat dhe iniciativat e ndryshme ndërkombëtare.

Ambasadorja Butel konfirmoi nga ana e saj zotimin e Qeverisë franceze për vazhdimin e përkrahjes së institucioneve të Kosovës në përpjekjet e tyre për forcimin e sundimit të ligjit dhe arritjen e standardeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

**20 nëntor 2021**



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare disaditëshe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të premten, më 19 nëntor 2021, kryetarja Caka – Nimani u takua në Uashington me zv.ndihmës Prokurorin e Përgjithshëm të SHBA-ve dhe Këshilltarin për çështje ndërkombëtare në Departamentin e Drejtësisë, z. Bruce C. Swartz.

Pasi që i shprehu falënderimin për ndihmën e vazhdueshme që SHBA-të i kanë ofruar Kosovës dhe zhvillimit institucional të saj ndër vite, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit, kryetarja Caka – Nimani e njoftoi z. Swartz përkitazi me të arriturat dhe sfidat në gjyqësinë kushtetuese. Të dyja palët në vazhdim shkëmbyen pikëpamjet e tyre lidhur me mekanizmat më efektiv për forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës dhe rëndësinë e konsolidimit të sundimit të së drejtës në çdo vend demokratik.

Gjatë qëndrimit në Uashington, kryetarja Caka – Nimani u takua edhe me zyrtarë të lartë në Departamentin e Shtetit dhe Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), si dhe me përfaqësues të SHBA-ve në Komisionin e Venecias.



Vizitën e saj në SHBA, kryetarja Caka-Nimani e filloi fillimjavën e kaluar me pjesëmarrjen në Konferencën Ndërkombëtare me temë: *“Të drejtat e patjetërsueshme dhe traditat e konstitucionalizmit”*, organizuar nga Instituti Kellog për Studime Ndërkombëtare në Universitetin Notre Dame, në të cilën pjesëmarrës ishin gjyqtarë e kryetarë të gjykatave kushtetuese dhe supreme të shteteve anembanë botës,



si dhe akademikë dhe ekspertë të shquar ndërkombëtarë në fushën e të drejtave të njeriut. Duke qenë njëra nga panelistet kryesore në konferencë, kryetarja Caka – Nimani bëri një prezantim të detajuar përkitazi me traditën kushtetuese të Kosovës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në përputhje me parimet e mishëruara në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me ftesë të Fakultetit Juridik në kuadër të Universitetit Notre Dame, kryetarja Caka – Nimani gjithashtu mbajti edhe ligjëratë mbi historikun dhe traditën kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

#### 24 nëntor 2021



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, mori pjesë në tryezën me temë: *“Gratë në drejtësinë komerciale”*, organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, në bashkëpunim me Programin për Drejtësi Komerciale të USAID, në “Hotel International Prishtina” në Prishtinë. Në fjalimin e mbajtur para audiencës së përbërë nga gratë përfaqësuese të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, si dhe nga fusha e biznesit, kryetarja Caka – Nimani ndër të tjera tha se, integrimi i plotë i grave në jetën publike dhe në sektorin privat vazhdon të jetë i sfiduar me pengesat strukturore, sociale, ekonomike dhe kulturore. Kryetarja Caka – Nimani në vazhdim theksoi se, *“nuk është e rastësishme që hartuesit e Kushtetutës kanë rregulluar barazinë para ligjit në nivel preambule”*, duke e cilësuar barazinë gjinore si vlerë themelore dhe si parakusht esencial për zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokratik të shoqërisë. Ajo e vlerësoi si jashtëzakonisht me rëndësi për drejtësinë komerciale përmbarimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe përmirësimin e mekanizmave përmes së cilave gratë do të kenë qasje më të lehtësuar në drejtësi, si dhe pjesëmarrje më të madhe në vendimmarrje.

#### 1 dhjetor 2021



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim një delegacion të përbërë nga Avokati i Popullit të Kosovës, z. Naim Qelaj, Avokati i Popullit të Shqipërisë, znj. Erinda Ballanca, Avokati i Popullit të Maqedonisë së Veriut, z. Naser Zyberi, dhe Komisioneri i Shqipërisë për Mbrojtje nga Diskriminimi, z. Robert Gajda. Pasi që i informoi mysafirët përkitazi me konsolidimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në harmoni me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kryetarja Caka – Nimani vuri në dukje rëndësinë e qëndrueshmërisë së jurisprudencës të gjykatave në ndarjen e drejtësisë për qytetarët, duke respektuar parimin e sigurisë juridike.

Gjatë takimit, të gjitha palët konfirmuan misionin fisnik që kanë gjykatat kushtetuese dhe institucionet e avokatit të popullit në garantimin e funksionimit demokratik të mekanizmave shtetëror për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me ç’rast shkëmbyen përvojat reciproke përkitazi me ankesat kushtetuese dhe problematikat që hasin qytetarët e kategorive të ndryshme në vendet e tyre. Me rëndësi të veçantë në takim u vlerësuan edhe reformimi dhe forcimi i kornizës ligjore shtetërore përkitazi me të drejtat e njeriut, si dhe informimi i vazhdueshëm i qytetarëve lidhur me të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara.

#### 7 dhjetor 2021

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, i udhëhequr nga kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi në Shkup për vizitë zyrtare në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut.

Gjatë qëndrimit në kryeqytetin maqedonas, kryetarja Caka – Nimani dhe homologa e saj, znj. Dobrila Kacarska, diskutuan bashkërisht me gjyqtarët e të dy gjykatave mbi modalitetet e intensifikimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit institucional në fushat me interes të ndërsjellë. Të dyja palët u dakorduan për hapat e radhës që duhet ndërmarrë në drejtim të thellimit të bashkëpunimit, me fokus të veçantë në

shkëmbin e përvojave drejt avancimit të praktikave përkatëse gjyqësore.

Në vijim të vizitës, gjyqtarët e të dy gjykatave morën pjesë në punëtorinë e përbashkët të organizuar përkitazi me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut, me referencë të veçantë në zbatimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



## 15 dhjetor 2021

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim një delegacion nga Republika e Shqipërisë i përbërë nga Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof. Dr. Artan Hoxha dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, z. Artur Metani, të shoqëruar nga Dekani i Fakultetit Juridik në Universitetit e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prof. Dr. Avni Puka.



Rëndësia e komunikimit të vazhdueshëm ndërmjet spektrit akademik dhe institucional, unifikimi i standardit gjuhësor të përdorur në hartimin e dokumenteve ligjore dhe nevoja për reforma të vazhdueshme në kornizën ligjore të të dyja vendeve, ishin ndër temat që u diskutuan në takimin e përbashkët.

Kryetarja Caka – Nimani në vazhdim i informoi mysafirët nga Tirana edhe për marrëdhëniet e shkëlqyera të bashkëpunimit me gjykata kushtetuese rajonale, e posaçërisht me Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë.

Rektori Hoxha theksoi nga ana e tij rëndësinë e organizimit të praktikës institucionale të gjeneratave të reja të juristëve në fushën e së drejtës kushtetuese dhe nevojën për më shumë investime në këtë aspekt nga qeveritë e të dyja vendeve, për derisa Inspektori Metani nënvizoi rëndësinë e forcimit të mekanizmave

të pavarur shtetëror për sigurimin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.





## Aktgjykim

KO 61/21

### Parashtrues

Slavko Simiq dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

*Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës [nr. 08/V-005], të 22 marsit 2021, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës*

Në kërkesën KO 61/21, objekt i çështjes së shqyrtimit ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës [nr. 08/V-005], të 22 marsit 2021, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës pretenduan që Vendimi për zgjedhjen e Qeverisë nuk është në përputhje me nenin 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës, sepse Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal nuk është zgjedhur pas konsultimit të shumicës së deputetëve të cilët përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvendin e Kosovës.

Çështja kryesore që ngërthen ky rast ndërlidhet me mënyrën e caktimit të ministrave që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Qeveri. Para Gjykatës, nuk ishte kontestuese mënyra e caktimit të një (1) ministri që caktohet detyrimisht nga komuniteti Serb; ose një (1) ministri që caktohet detyrimisht nga komuniteti e tjera jo shumicë, por caktimi i ministrit të “tretë” në Qeveri nga komunitetet jo shumicë, që është detyrim kushtetues në rast se Qeveria përbëhet nga më tepër se dymbëdhjetë (12) ministra. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës pretenduan se për caktimin e ministrit të “tretë” në Qeveri është i nevojshëm konsultimi/miratimi nga shumica e të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvend, përkatësisht nga të paktën njëmbëdhjetë (11) nga njëzet (20) deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë.

Gjykata Kushtetuese theksoi se, për qëllime të kushtetutshmërisë së përbërjes së Qeverisë, bazuar në nenin 96 të Kushtetutës, në Qeveri duhet të jenë së paku një (1) ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera jo shumicë.

Mënyra e zgjedhjes së këtyre ministrave dallon varësisht nëse kandidati i propozuar për ministër është deputet i Kuvendit ose jo. Për caktimin e një kandidati për Ministër nga radhët e deputetëve të Kuvendit, është i nevojshëm konsultimi me partitë, koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Ndërsa, për caktimin e një kandidati për ministër jashtë radhëve të deputetëve të Kuvendit, është i nevojshëm miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë. Gjykata Kushtetuese gjithashtu theksoi se, Kushtetuta përcakton që në rast se përbërja e një Qeverie ka më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, Qeveria duhet të ketë edhe një ministër të tretë, “i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë”. Gjykata tutje theksoi se, për sa i përket ministrit të tretë, Kushtetuta i mundëson diskrecion mandatarit për Kryeministër përkitazi me radhët e komuniteteve përkatëse, nga të cilët mund të zgjidhet një ministër i tretë, duke mos përcaktuar detyrimisht që ky ministër duhet të propozohet/miratohet nga deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb ose nga deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë, por duke kërkuar që të ndiqet procedura e njëjtë përkatësisht konsultimi/miratimi i “komunitetit në fjalë”, varësisht nëse kandidati përkatës është deputet i Kuvendit ose jo.

Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata theksoi se ministri i “tretë” nga komunitetet jo shumicë, përkatësisht Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, ishte deputet i Kuvendit i zgjedhur në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, i deklaruar se përfaqëson një nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend në kuptim të nenit 64 [Struktura e Kuvendit] të Kushtetutës dhe i cili është propozuar për këtë pozitë në konsultim me deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend. Duke marrë parasysh që kandidati përkatës ishte deputet i zgjedhur i Kuvendit, miratimi formal nga komuniteti në fjalë nuk është detyrim kushtetues, ndërsa para Gjykatës nuk kishte asnjë pretendim që deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë nuk ishin konsultuar në propozimin e këtij kandidati për ministër, përkundër faktit që Gjykata u kishte mundësuar që të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën e dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës.

Gjykata përfundimisht sqaroi që bazuar në nenin 96 të Kushtetutës, i detyrueshëm është konsultimi me ose miratimi i deputetëve që përfaqësojnë “komunitetin në fjalë”, përkatësisht deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb ose që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë, varësisht nëse kandidati përkatës është deputet i Kuvendit ose jo, dhe jo shumica e të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë. Në rrethanat e rastit konkret, kandidati i propozuar për ministër ishte deputet i Kuvendit dhe

për pasojë miratimi formal i tij nuk ishte detyrim kushtetues, ndërsa para Gjykatës nuk kishte asnjë pretendim që detyrimi për konsultimin e “komunitetit në fjalë” nuk ishte shteruar. Prandaj, Gjykata konstatoi që, Vendimi i kontestuar i Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë nuk është nxjerrë në kundërshtim me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës.



### Aktgjykim

KI 01/21

### Parashtruese

Ajshe Aliu

*Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ-UZVP. nr. 37/2020], të 11 qershorit 2020*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me të drejtën e pretenduar të një nëne biologjike për njoftuar/kontaktuar fëmijën e saj të dhënë në adoptim dhe i cili tashmë ka arritur moshën madhore, në specifikat e sqaruar në Aktgjykimin e publikuar. Çështjet që ngërthen kërkesa, ndër të tjera, ndërlidhen me të drejtën në jetë private dhe parimet e përjashtimet përkatëse, siç janë garantuar përmes neneve respektive të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe praktikës përkatëse të Gjykatës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Më specifikisht, nga shkresat e lëndës rezultoi se parashtruesja e kërkesës, më 1 mars 2016, në Qendrën për Punë Sociale në kuadër të Komunës së Prishtinës kishte parashtruar kërkesë, përmes së cilës kishte kërkuar që fëmija i saj biologjik i moshës madhore, të cilin e kishte dhënë për birësim në vitin 1989, të njoftohet për: (i) ekzistimin e nënës së tij biologjike; dhe (ii) interesimin e saj për ta njoftuar atë. Qendra për Punë Sociale ishte përgjigjur duke theksuar se (i) nuk ka bazë ligjore për të njoftuar fëmijën e saj biologjik në lidhje me birësimin e tij; dhe se (ii) bazuar në paragrafin 2 të nenit 194 (Parimet) të Ligjit për Familjen të Kosovës, qasja në informatë në lidhje me prindërit biologjikë i garantohet vetëm fëmijës së adoptuar të moshës madhore në bazë të kërkesës së

tij/saj. Si rezultat i kërkesës së parashtrueses së kërkesës për rishqyrtim të përgjigjes së Qendrës për Punë Sociale, konstatimi i kësaj të fundit ishte konfirmuar edhe nga Komisioni i Ankesave në kuadër të Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Për pasojë, parashtruesja e kërkesës në Gjykatën Themelore në Prishtinë kishte parashtruar kërkesëpadi përmes së cilës, ndër tjerash, kishte kërkuar që të detyrohet Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare që të informojë fëmijën e saj biologjik në lidhje me birësimin e tij. Gjykata Themelore e kishte refuzuar si të pabazuar padinë e parashtrueses së kërkesës duke vërtetuar konstatimet e lartcekura të Qendrës për Punë Sociale dhe të Komisionit për Ankesa pranë Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe duke konstatuar se bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Qendra për Punë Sociale nuk është e obliguar që të njoftojë fëmijën në lidhje me birësimin e tij dhe se të drejtën e qasjes në të dhëna të tilla e ka vetëm i adoptuari i moshës madhore në bazë të kërkesës së tij. Në vijim, parashtruesja e kërkesës kundër këtij Aktgjykimi të Gjykatës Themelore, kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, dhe kjo e fundit kishte refuzuar ankesën e saj e si të pabazuar duke vërtetuar konstatimin e gjykatës së shkallës së parë. Si rezultat i kërkesës së parashtrueses së kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të parashtruar në Gjykatën Supreme, kjo e fundit përmes Aktgjykimit të 11 qershorit 2020, këtë kërkesë të parashtrueses së kërkesës gjithashtu e kishte refuzuar si të pabazuar. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar kishte vërtetuar konstatimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit dhe kishte përfunduar se të dhënat dhe rrethanat e adoptimit nuk duhet të zbulohen ose të hulumtohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe të fëmijës, përveç nëse kjo kërkohej për arsye të veçanta dhe për arsye të interesit publik.

Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës i kontestoi konstatimet e lartcekura të Gjykatës Supreme, përfshirë edhe ato të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë. Thelbi i pretendimit të parashtrueses së kërkesës para Gjykatës ishte se gjykatat e rregullta i kanë shkelur asaj të drejtën për jetë private, të garantuar me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke mos i miratuar asaj kërkesën për njoftimin e fëmijës së saj biologjik në lidhje me ekzistimin e nënës së tij biologjike dhe interesimin e parashtrueses së kërkesës për ta njoftuar atë. Si rezultat i kësaj, ajo po ashtu kishte pretenduar: (i) shkelje të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor; dhe (iii) shkelje të nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata u fokusua në garancitë e mishëruara në nenin 36 (E Drejta e Privatësisë) të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës



private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe në këtë kontekst, së pari shtjellojë parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe më pas, aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata theksoi se kërkesa e parashtrueses së kërkesës, përmes së cilës kishte shprehur interesimin e saj për ta njoftuar fëmijën e saj të dhënë për adoptim në vitin 1989, ngërthen elemente që i përkasin një pjese të rëndësishme të identitetit të saj si nënë biologjike dhe të cilat afektojnë të drejtën e saj për jetë private në kuptim të nocionit të “jetës së saj private” të garantuar me paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Thënë këtë, duke pasur parasysh që ky pretendim afekton të drejtën e saj për jetë private, Gjykata rikujtoi se, sipas praktikës së saj dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit të rasteve për të konstatuar nëse në një rast konkret ka pasur kufizim dhe shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Konventë, aplikon të njëjtat koncepte, përkatësisht nëse kufizimi apo ndërhyrja përkatëse: (i) është “në përputhje me ligjin” ose “e përcaktuar me ligj”; (ii) ka “ndjekur një qëllim legjitim”; dhe (iii) është “e domosdoshme në një shoqëri demokratike.” Në këtë kontekst, Gjykata në rrethanat e rastit konkret, vlerësoi se vendimet e gjykatave të rregullta, përmes së cilave ishte refuzuar kërkesa specifike e parashtrueses së kërkesës: (i) ishin të bazuara në ligj; (ii) kishin ndjekur një qëllim legjitim – mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të fëmijës së adoptuar dhe familjes së tij adoptuese; dhe (iii) kishin ndjekur një ekuilibër të drejtë në mes të interesave të fëmijës së adoptuar, tashmë të moshës madhore, dhe respektimin e të drejtës së tij private dhe familjare brenda familjes së tij adoptuese.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerësoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk ishte i përfshirë në shkelje të së drejtës së saj për jetë private të garantuar me paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ndërsa, përkitazi me pretendimin për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata, duke aplikuar parimet e përgjithshme të vendosura përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke rikujtuar që bazuar në të njëjtat dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret, konstatoi se në rrethanat parashtrueses së kërkesës, Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmbush kriteret dhe standardin për një vendim të arsyetuar gjyqësor, ashtu siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës. Përfundimisht, mbështetur në rrethanat e rastit konkret dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është në

pajtueshmëri me (i) nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe po ashtu (ii) nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejtat në proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



## Aktgjykim

KI 84/21

## Parashtrues

Telekomi i Kosovës Sh.A.

*Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [CML.nr.12/20], të 20 janarit 2021*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me Marrëveshjen për Shërbimet Mbështetëse të Operatorit Virtual të Rrjetit Mobil (Marrëveshja), të lidhur në mes të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht Telekomit të Kosovës dhe Kompanisë “Dardafon”, lidhur me ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile. Marrëveshja e lartcekur, kishte rezultuar në një kontest në mes të palëve dhe si pasojë, kompania “Dardafon” kishte iniciuar tri (3) procedura të ndryshme, si në vijim: (i) procedurën para Tribunalit të Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike Ndërkombëtare (ICC) lidhur me zgjidhjen e kontestit nga Marrëveshja e lartcekur, e cila kishte rezultuar në nxjerrjen e Vendimit përmes të cilit, ndër tjerash, detyrohej parashtruesi i kërkesës që kompanisë “Dardafon”, t’i paguaj një shumë të caktuar parash për shkak të mos respektimit të Marrëveshjes; (ii) procedurën lidhur me njohjen e Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit të ICC-së, e cila kishte rezultuar në njohjen e këtij Vendimi nga Gjykata Themelore, vendim ky që ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe rrjedhimisht kishte arritur formën e prerë; si dhe (iii) procedura lidhur me përmbarrimin e Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit të ICC-së. Objekti i çështjes para Gjykatës ndërlidhej vetëm me procedurën e tretë, përkatësisht procedurën lidhur me përmbarrimin e Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit të

ICC-së. Kontesti në procedurë përmbarimore kishte filluar pasi parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar prapësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Urdhrit Përmbarimor të nxjerrë nga Përmbaruesi Privat pas kërkesës së kompanisë “Dardafon”.

Kontestuese ndërmjet palëve në procedurat e zhvilluara para Gjykatës Themelore, ndër tjerash, ishte shuma e përgjithshme e borxhit kryesor, përkatësisht shuma e cila do të ishte objekt përmbarimi. Për pasojë, Gjykata Themelore kishte nxjerr një Konkluzion përmes të cilit detyroi kompaninë “Dardafon”, që në afat prej tri (3) ditësh, të bëjë precizimin e propozimit për përmbarim përkitazi me shumën e përgjithshme të borxhit kryesor. Në përgjigje të konkluzionit të lartcekur, kompania “Dardafon” dorëzoi në Gjykatën Themelore plotësimin e propozimit për përmbarim dhe një ekspertizë vetanake. Këto dokumente, Gjykata ia kishte dorëzuar edhe parashtruesit i kërkesës dhe i cili i kishte pranuar më 6 korrik 2020, ndërsa përgjigjen e tij në Gjykatë e kishte dorëzuar, të nesërmen përkatësisht, më 7 korrik.

Megjithatë, më 6 korrik 2020, Gjykata Themelore kishte nxjerrë vendimin e saj, duke refuzuar si të pabazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me shumën prej 24,684,003.15 euro, ndërsa kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin lidhur me shumën prej 315,99.85 euro. Kundër këtij Aktvendimi, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar ankesë në Gjykatën e Apelit me pretendimin se Gjykata Themelore, mes tjerash, nuk e kishte marrë fare për bazë parashtruesin e tij, sepse Aktvendimi i Gjykatës Themelore ishte nxjerrë një ditë më herët, pra më 6 korrik 2020, pa pritur dhe pa e shqyrtuar përgjigjen e parashtruesit të kërkesës rreth precizimit të propozimit për përmbarim të kompanisë “Dardafon” dhe dokumenteve tjera, përfshirë ekspertizën, në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me ligj dhe në cenim të parimit të “barazisë së armëve” të garantuar me Kushtetutë. Gjykata e Apelit, e kishte refuzuar si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke mos adresuar pretendimin përkitazi me pamundësinë e deklarimit të parashtruesit të kërkesës rreth precizimit të propozimit për përmbarim të kompanisë “Dardafon”. Zyra e Prokurorit të Shtetit kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Kjo e fundit gjithashtu e kishte refuzuar kërkesën si të pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Kushtetuese, ndër tjerash, pretendoi se vendimet e gjykatave të rregullta në procedurë përmbarimi ishin nxjerrë në shkelje të parimit të “barazisë së armëve” të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse (i) Gjykata Themelore i kishte mohuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës që të deklarohet lidhur me precizimin e borxhit të kompanisë “Dardafon” dhe dokumenteve e provave tjera shtesë, përfshirë ekspertizën, sepse Aktvendimi i Gjykatës Themelore ishte nxjerrë në ditën kur parashtruesi i kërkesës kishte pranuar

dokumentet përkatëse dhe Gjykata nuk kishte pritur as një ditë për përgjigjen e parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) Gjykata e Apelit, nuk kishte adresuar fare pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me pretendimin për shkeljen e parimit të “barazisë së armëve”.

Në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata, fillimisht shtjelloi parimet e praktikës së saj gjyqësore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkitazi me parimin e “barazisë së armëve” dhe më pas i aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata, ndër tjerash, rikujtoi se, sipas parimit të “barazisë së armëve”, është e papranueshme që një palë në procedurë të paraqesë vërejtje apo komente para gjykatave të rregullta, të cilat kanë për qëllim që të ndikojnë në vendimmarrjen e gjykatës, pa dijeninë e palës tjetër apo pa i dhënë mundësi palës tjetër të përgjigjet përkitazi me to. Gjykata po ashtu theksoi se, mangësitë procedurale në instancë të parë mund të përmirësohen nëpërmjet ankesës, me kusht që institucioni i cili vendos për ankesën përkatëse, të ketë “juridiksion të plotë” lidhur me rastin para saj.

Gjykata, pasi i analizoi shkresat e lëndës dhe siç është sqaruar detajisht në Aktgjykimin e publikuar gjeti se: (i) në cenim të parimit të “barazisë së armëve”, Gjykata Themelore i kishte mohuar parashtruesit të kërkesës të drejtën që të deklarohet lidhur me parashtruesin e kompanisë “Dardafon” përkitazi me precizimin e propozimit për përmbarim dhe dokumenteve e provave shtesë, kjo pasi që, Aktvendimi i Gjykatës Themelore, ishte nxjerrë po në ditën kur parashtruesi i kërkesës kishte pranuar dokumentet dhe pa pritur përgjigjen përkatëse të tij; dhe (ii) Gjykata Supreme, e veçanërisht Gjykata e Apelit, e cila edhe pse kishte “juridiksion të plotë” për të vendosur lidhur me rastin, duke përfshirë kompetencën për të korrigjuar të metat e procedurës së ndjekur në Gjykatën Themelore, kishin dështuar të adresojnë të njëjtat, duke mos rikuperuar për pasojë, cenimin e parimit të “barazisë së armëve”.

Rrjedhimisht dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se, Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, janë nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke e kthyer të njëjtin për rivendosje në Gjykatën e Apelit, marrë parasysh që kjo e fundit, siç është sqaruar në Aktgjykim, ka “juridiksion të plotë” për të adresuar të metat procedurale të cilat kanë rezultuar në kontestimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore.





## Aktgjykim

KO 127/21

### Parashtrues

Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

*Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 08-V-029], të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*

Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata vlerësoi kushtetutshmërinë e Vendimit [nr. 08-V-029], të 30 qershorit 2021, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes të cilit janë shkarkuar pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij akti është parashtruar në Gjykatë nga njëmbëdhjetë (11) deputetë të Kuvendit, bazuar në autorizimet e përcaktuara përmes paragrafit 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Kuvendit, Gjykata njëzëri vendosi që (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) Vendimi [nr.08/V-029] i 30 qershorit 2021 i Kuvendit nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës; (iii) të shfuqizojë Vendimin e lartcekur; (iv) të shfuqizojë Masën e Përkohshme të përcaktuar përmes Vendimit të Gjykatës, të 21 tetorit 2021; dhe (v) të refuzojë kërkesën për seancë dëgjimore.

Gjykata rikujtoi që më 30 qershor 2021, duke u bazuar në rekomandimin e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, Kuvendi votoi për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Duke kontestuar kushtetutshmërinë e këtij akti, parashtruesit e kërkesës, pretenduan para Gjykatës se Vendimi i kontestuar i Kuvendit, cenon pavarësinë e Këshillit, të garantuar me nenin 101 [Shërbimi Civil] dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, duke theksuar se Këshilli, si organ i pavarur kushtetues, nuk mund t'i nënshtrohet ndërhyrjeve nga ana e Kuvendit dhe se për shkarkimin kolektiv të anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, nuk janë

përbushur asnjë nga kriteret ligjore të përcaktuara përmes Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kundërargumentet e dorëzuara në Gjykatë nga deputetja përkatëse e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje!, në esencë, theksojnë se Kuvendi në nxjerrjen e Vendimit të kontestuar ka vepruar në përputhshmëri me funksionin e tij mbikëqyrës, ndërsa rasti i ngritur para Gjykatës, nuk ngërthen çështje kushtetuese, sepse Kushtetuta nuk përcakton procedurën e zgjedhjes dhe të shkarkimit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

Në vlerësimin e argumenteve dhe kundërargumenteve përkatëse dhe rrethanave që ngërthen rasti, Gjykata (i) fillimisht elaboroi statusin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe anëtarëve të tij, duke u referuar në Kushtetutë, ligjet e aplikueshme dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës; (ii) elaboroi kompetencën e Kuvendit dhe kufizimet përkatëse në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës; dhe në fund (iii) aplikoi këto parime në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Kuvendit.

Përkritazi me pavarësinë institucionale të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, Gjykata, ndër të tjera, theksoi se (i) Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës është institucion i themeluar me nenin 101 të Kushtetutës; (ii) Kushtetuta i ka përcaktuar Këshillit statusin e institucionit të "pavarur" në ushtrimin e funksionit të tij kushtetues, përkatësisht, "sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil"; (iii) bazuar në praktikën gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës, është përcaktuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës gëzon prerogativat e një "tribunali" në kuptim të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe se vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës janë "përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme"; dhe (iv) kontrolli i ligjshmërisë së vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës bëhet përmes inicimit të konflikt administrativ në gjykatën kompetente, rrjedhimisht, ato i nënshtrohen kontrollit të pushtetit gjyqësor.

Përkritazi me pavarësinë e anëtarëve Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, Gjykata theksoi se (i) pavarësia e ushtrimit të funksionit kushtetues të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për "sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil" nënkupton edhe pavarësinë e anëtarëve të tij në vendimmarrje; dhe (ii) për të njëjtin qëllim, vetë Kuvendi përmes Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka përcaktuar imunitetin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi "lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit", përkatësisht, për pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre si anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

Përkritazi me kompetencën e Kuvendit për të mbikëqyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, Gjykata



theksoi se (i) kompetenca e Kuvendit për të mbikëqyrë punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit është e përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës; dhe (ii) në rastin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, kjo kompetencë e Kuvendit është më tej e detajuar përmes Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe përfshinë, ndër tjerash, edhe autorizimin e Kuvendit për ndërprerjen e mandatit të anëtarëve të Këshillit në rrethanat e përcaktuara përmes nenit 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) të këtij ligji. Megjithatë, Gjykata tutje theksoi se, ushtrimi i kompetencës për ndërprerje të mandatit, përjashton ndërprerjen e të njëjtit për shkak të “vendimmarrjes” së anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, sepse rrethana të tilla, (i) do të cenonin pavarësinë institucionale të Këshillit dhe anëtarëve të tij, siç është përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës; dhe (ii) do të ishin në kundërshtim me vetë përcaktimin e Kuvendit që anëtarët e Këshillit të gëzojnë imunitet nga shkarkimi për vendimmarrjen, siç është përcaktuar përmes dispozitave përkatëse të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Kuvendit, Gjykata rikujtoi se i njëjti është referuar në pikat 1.3 dhe 1.1 të paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. E para, përkatësisht pika 1.3 e nenit 15 e këtij ligji, përcakton mundësinë e ndërprerjes së mandatit “në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij”. Megjithatë, Vendimi i kontestuar i Kuvendit, nuk përmban asnjë fakt e arsyetim se si pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës kolektivisht, mund të kenë ushtruar detyrat e anëtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës në papajtueshmëri me funksionin e tyre. Ndërsa, e dyta, përkatësisht pika 1.1 e nenit 15 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përcakton mundësinë e ndërprerjes së mandatit “për shkelje të dispozitave të këtij ligji”. Në kontekst të kësaj të fundit, Vendimi i kontestuar i Kuvendit, thekson se “është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK, për arsye se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes.” Gjykata theksoi se Vendimi i kontestuar i Kuvendit, nuk i referohet asnjë fakti e arsyetimi në mbështetje të shkeljes së pretenduar të kësaj dispozite nga pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës kolektivisht, përpos vënies theks në “vendimmarrjen” e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Kjo për më tepër, rezulton nga fakti që Vendimit të kontestuar, i kishin paraprirë një sërë veprimesh dhe pyetjesh të Komisionit përkatës të Kuvendit drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës përkitazi me vendimmarrjen në raste konkrete.

Në këtë kontekst, Gjykata ritheksoi se (i) Kuvendi ka kompetencë kushtetuese të mbikëqyrë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, duke përfshirë mundësinë e ndërprerjes së mandatit të anëtarëve të tij në rastet e

përcaktuara në Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; por se (ii) anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nuk mund të shkarkohen vetëm për shkak të “vendimmarrjes” së tyre sepse përkitazi me të njëjtën kanë pavarësi kushtetuese dhe ligjore, si dhe imunitet nga shkarkimi, siç është përcaktuar në vetë ligjin që ka miratuar Kuvendi. Për më tepër që, bazuar në po të njëjtin ligj, ligjshmëria e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i nënshtrohet kontrollit të pushtetit gjyqësor dhe jo atij legjislativ.

Në këtë kontekst, Gjykata theksoi se Kuvendi duke shkarkuar (5) pesë anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës në mënyrë kolektive dhe pa shtjellimin e asnjë fakti e të bazuar në ligj, por vetëm me arsyetimin se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës “nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes”, përkatësisht për shkak të vendimmarrjes së tyre në raste konkrete, për të cilën anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës gëzojnë pavarësi dhe imunitet nga shkarkimi dhe e cila vendimmarrje, për më tepër, i nënshtrohet kontrollit të pushtetit gjyqësor dhe jo atij legjislativ, ka tejkaluar kufijtë e kompetencës së mbikëqyrjes së punës së institucioneve publike, të përcaktuar me paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës, në cenim të garancive përkitazi me pavarësinë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës në ushtrimin e funksionit të tij të përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë kontekst, Gjykata theksoi që në ushtrimin e kompetencës kushtetuese për mbikëqyrjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, Kuvendi ka gjithashtu detyrimin që të ruajë pavarësinë e Këshillit, të cilën vetë ia ka atribuar përmes miratimit të Kushtetutës dhe Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Për pasojë dhe përfundimisht, Gjykata konstatoi se Vendimi [nr. 08/V-029] i Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.





## GJEDNJ – Vendime të rëndësishme (1 korrik – 31 dhjetor 2021)

### \* Shkelje të qarta në heqjen e të drejtave të kontaktit nga prindi që i nënshtrohet ndryshimit të gjinisë (06/07/2021)

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **A.M. dhe të Tjerët kundër Rusisë** (kërkesa nr. 47220/19) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe **shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit)** në lidhje me nenin 8. Rasti kishte të bënte me një vendim të gjykatës për t'i dhënë fund të drejtave të kontaktit të A.M. me fëmijët e saj, sepse ajo kishte kaluar në tranzicion gjinor në atë kohë. Gjykata konstatoi në veçanti se nuk kishte dëshmi për ndonjë dëmtim të mundshëm për fëmijët nga tranzicioni dhe se gjykatat vendase nuk kishin shqyrtuar rrethanat e veçanta të familjes. Për më tepër, ajo zbuloi se vendimi ishte bazuar qartë në identitetin gjinor të parashtrueses së kërkesës dhe kështu kishte qenë i njëanshëm.

### \* Dallimi në të drejtën për pushim prindëror përbën diskriminim gjinor (06/07/2021)

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Gruba dhe të Tjerët kundër Rusisë** (kërkesat nr. 66180/09, 30771/11, 50089/11 dhe 22165/12) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, konstatoi njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit)** në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për katër kërkesat, dhe **shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (e drejta për një proces të rregullt)** të Konventës përkitazi me kërkesën nr. 22165/12 (z. Morozov). Rasti kishte të bënte me dallimin në të drejtën për pushim prindëror ndërmjet policëve dhe policeve. Gjykata konstatoi se dallimi në trajtim ndërmjet policëve dhe policeve për sa i përket të drejtës për pushim prindëror nuk ishte i justifikuar. Autoritetet nuk kishin arritur të balanconin qëllimin legjitim të efektivitetit operacional të policisë dhe të drejtave të parashtruesve për të mos u diskriminuar mbi baza gjinore. Gjykata arriti në përfundimin se ky dallim në trajtim kishte çuar në diskriminim gjinor.

### \* Rusia dështoi të justifikonte mungesën e ndonjë mundësie për çiftet e së njëjtës gjini që të pranonin zyrtarisht marrëdhënien e tyre (13/07/2021)

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Fedotova dhe të Tjerët kundër Rusisë** (kërkesat nr. 40792/10, 30538/14 dhe 43439/14) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, konstatoi njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të

Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Rasti kishte të bënte me refuzimin e regjistrimit të njoftimit të martesës së parashtruesve, të cilët janë çiftet e së njëjtës gjini. Gjykata konstatoi se Rusia kishte detyrim për të siguruar respektimin e jetës private dhe familjare të parashtruesve duke ofruar një kornizë ligjore që do t'u mundësonte njohjen dhe mbrojtjen e marrëdhënieve të tyre sipas ligjit të brendshëm. Mungesa e çdo mundësie për çiftet e së njëjtës gjini që të pranohen marrëdhëniet e tyre zyrtarisht krijoi një konflikt midis realitetit social të parashtruesve dhe ligjit. Gjykata hodhi poshtë argumentin e Qeverisë se interesat e komunitetit në tërësi mund të justifikonin mungesën e mundësive për çiftet e së njëjtës gjini për të zyrtarizuar marrëdhëniet e tyre. Ajo arriti në përfundimin se, duke mohuar qasjen në njohjen formale të statusit për çiftet e së njëjtës gjini, autoritetet ruse kishin shkuar përtej diskrecionit (margjina e vlerësimit) që gëzonin ato. Gjykata deklaroi se zgjedhja e formës më të përshtatshme të regjistrimit të sindikatave së njëjtës gjini mbetej në diskrecionin e Shtetit të paditur.

### \* Largimi i një gazetari turk në Turqi, pa shqyrtuar kërkesën e tij për azil dhe rrezikun e keqtrajtimit, është shkelje e Konventës (20/07/2021)

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **D kundër Bullgarisë** (kërkesa nr. 29447/17) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, konstatoi njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues)** dhe **shkelje të nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me arrestimin në kufirin midis Bullgarisë dhe Rumanisë të një gazetari turk që pretendonte se po ikte nga rreziku i persekutimit politik në vendin e tij dhe largimin e tij të menjëhershëm në Turqi. Ngjarjet ndodhën tre muaj pas tentativës për grusht shtet të vitit 2016 në Turqi. Përpara Gjykatës, parashtruesi u ankua se autoritetet bullgare kishin refuzuar të fillonin procedurën e azilit dhe e kishin kthyer atë në Turqi, duke e ekspozuar kështu ndaj një rreziku real të keqtrajtimit. Gjykata konstatoi në veçanti se pavarësisht faktit se parashtruesi i kërkesës kishte shprehur frikën se mund të përballej me keqtrajtim në rast se do të kthehej në Turqi, autoritetet bullgare nuk e kishin shqyrtuar kërkesën e tij për mbrojtje ndërkombëtare.

### \* Rrethanat që lidhen me një vizitë në vendin e krimit nga kryetari i Gjykatës Penale ngjalli dyshime lidhur me paanshmërinë e tij (31/08/2021)

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Karrar kundër Belgjikës** (kërkesa nr. 61344/16) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, konstatoi njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 6 (e drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane për të



Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me procedurën penale kundër z. Karrar, pas së cilës ai u dënua për vrasjen e dy fëmijëve të tij dhe u dënua me burgim të përjetshëm. Në Gjykatë, parashtuesi i kërkesës u ankua për mungesë të paanshmërisë së Kryetarit të Gjykatës Penale, posaçërisht në lidhje me takimin ndërmjet kryetarit dhe nënës së fëmijëve një javë para gjyqimit. Gjykata konstatoi se sjellja e kryetarit të Gjykatës Penale mund të kishte ngjallur dyshime të arsyetuara në mënyrë objektive për paanshmërinë e tij objektive, duke vënë në pikëpyetje paanshmërinë e vetë Gjykatës Penale në përcaktimin e akuzës penale kundër z. Karrar. Ajo gjithashtu konstatoi se gjetja e një shkeljeje do të përbënte në vetvete një kompensim mjaftueshëm të drejtë për dëmin jomaterial të pësuar nga z. Karrar.

**\* Dënimi i një imami për shkak të postimeve të tij në Facebook ishte në kundërshtim me Konventën (31/08/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Üçdağ kundër Turqisë** (kërkesa nr. 23314/19), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (e drejta e qasjes në gjykatë)** dhe **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me dënimin penal të z. Üçdağ për shpërndarje të propagandës në favor të një organizate terroriste për shkak të dy postimeve të publikuara në llogarinë e tij në Facebook, si dhe refuzimin e kërkesës së tij individuale në Gjykatën Kushtetuese si të paafatshme. Në kohën përkatëse, z. Üçdağ ishte një zyrtar publik që punonte si imam në një xhami lokale. Postimet e kontestuara kishin përfshirë dy fotografi (të individëve me uniformë të ngjashme me atë të anëtarëve të PKK-së dhe të një turme që demonstronte në një rrugë publike përpara një zjarri), të shpërndara fillimisht nga dy përdorues të tjerë të Facebook. Gjykata vlerësoi se vendimet e gjykatave vendase dështuan që të japin një shpjegim adekuat të arsyeve pse përmbajtja e kontestuar duhej të interpretohej si aprovim, lavdërim dhe inkurajim i metodave të [përdorimit] të shtrëngimit, dhunës ose kërcënimeve të zbatuara nga PKK në kontekstin e publikimit të tyre. Ajo konstatoi se duke dënua z. Üçdağ me akuzën për propagandë në favor të një organizate terroriste për postimin e përmbajtjeve kontroverse në llogarinë e tij në Facebook, autoritetet vendase nuk kishin kryer një ushtrim të duhur balancues, në përputhje me kriteret e përcaktuara në praktikën e saj gjyqësore, ndërmjet të drejtës së parashtuesit për lirinë e shprehjes dhe synimeve legjitime të ndjekura.

Gjykata vendosi gjithashtu se interpretimi shumë i rreptë nga Gjykata Kushtetuese i afatit kohor për parashtrimin e një kërkesë individuale kishte ndërhyrë në mënyrë disproporcionale në të drejtën e parashtuesit për të vlerësuar meritat e kërkesës së tij individuale.

**\* Margjinalizimi i shoqatës parashtuese në**

**debatet politike në televizionin shtetëror cenoi lirinë e tij të shprehjes (31/08/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Associazione Politica Nazionale Lista Marco Pannella kundër Italisë** (kërkesa nr. 66984/14) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, me shumicë, se kishte pasur: **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me një ankesë nga shoqata parashtuese, një shoqatë politike italiane e përfaqësuar në Parlament, se nuk ishte ftuar të merrte pjesë në debatet politike të caktuara gjatë tri programeve kryesore të aktualitetit të transmetuara nga korporata shtetërore transmetuese RAI. Shoqata parashtuese ishte ankuar tek Autoriteti Rregullator i Komunikimit (AGCOM) për një mungesë të ekuilibrit në disavantazh të saj në programe të caktuara televizive. Në dy raste, nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim pasues lidhur me ankesën e saj. Vetëm pasi shoqata kishte aplikuar për herë të dytë në gjykatë, duke pretenduar shkelje të parimit *res judicata*, AGCOM më në fund kishte urdhëruar RAI-n të korrigjonte mungesën e ekuilibrit që kishte dëmtuar interesat e shoqatës parashtuese. Prandaj, ishte e qartë se shoqata parashtuese kishte munguar në tri programe televizive shumë të njohura – të cilat ishin bërë mjeti kryesor për prezantimin e debatit politik dhe përhapjen e ideve dhe opinioneve politike në media – dhe e kishin gjetur veten, nëse jo të përjashtuar, të paktën shumë të marginalizuar në mbulimin mediatik të debatit politik. Prandaj, kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

**\* Dënimi i një burri për dhënien e një bluze nipit të tij trevjeçar, të veshur në kopsht, me sloganet “Unë jam një bombë” dhe “Xhiahadi, i lindur më 11 shtator”, nuk ka shkelur nenin 10 të Konventës (02/09/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Z.B. kundër Francës** (kërkesa nr. 46883/15) Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi, njëzëri, se **nuk kishte pasur shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me dënimin e Z.B. për glorifikimin e vrasjes me dashje për shkak të sloganeve (“Unë jam një bombë” dhe “Xhiahadi, i lindur më 11 shtator”) në një bluzë që i kishte bërë dhuratë nipit të tij për ditëlindjen e tij të tretë. Djali më pas e kishte veshur bluzën në kopsht. Para gjykatave të brendshme dhe Gjykatës Evropiane, parashtuesi i kërkesës kishte pretenduar se parullat supozohej të kishin tone humoristike. Gjykata përsëriti se fjalimet humoristike ose format e të shprehurit të përdorura për efekt humoristik mbroreshin me nenin 10 të Konventës me kusht që ato të qëndronin brenda kufijve të lejuar me atë dispozitë. E drejta për humor nuk ishte e pakufizuar dhe kushdo që mbështetej në të drejtën e lirisë së shprehjes duhej të merrte përsipër “detyrat





dhe përgjegjësitë”. Gjykata theksoi se nuk mund të shpërfillte rëndësinë dhe peshën e kontekstit të përgjithshëm në këtë rast. Edhe pse kishin kaluar mbi 11 vjet që nga ngjarjet e 11 shtatorit 2001, deri në momentin e fakteve të rastit konkret, megjithatë ishte e vlefshme të theksohej se pak më parë kishte pasur sulme të tjera terroriste, të cilat kishin shkaktuar veçanërisht vdekjen e tre fëmijëve në një shkollë. Gjykata deklaroi gjithashtu se fakti që parashtruesi nuk kishte lidhje me një grup terrorist dhe nuk kishte përqafuar një ideologji terroriste nuk mund ta zvogëlonte rëndësinë e mesazhit fyes. Në rrethanat specifike të çështjes, Gjykata – e cila vuri në dukje se djali 3-vjeçar, si bartës i padashur i mesazhit, ishte instrumentalizuar – konstatoi se arsyet e dhëna nga gjykatat vendase për të dënuar parashtruesin e kërkesës, duke u mbështetur në nevojën për të parandaluar glorifikimin e dhunës masive, dukej si “relevant” dhe i “mjaftueshëm” për të justifikuar ndërhyrjen në fjalë. Më tej, ajo vlerësoi se sanksioni i shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës (gjobë dhe dënim me burg me kusht) nuk kishte qenë në disproporcion me qëllimin legjitim të synuar. Ndërhyrja e kontestuar kështu mund të konsiderohej si e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe nuk kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

**\* Diskriminimi i rastit të kujdestarisë për shkak të marrëdhënies së nënës me një grua tjetër (16/09/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **X. kundër Polonisë** (kërkesa nr. 20741/10) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, me gjashtë vota për, një kundër, se kishte pasur: **shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me procedurën që parashtruesja e ngriti për të kundërshtuar heqjen e fëmijës së saj më të vogël nga kujdestaria pasi ish-bashkëshorti i saj fitoi një ndryshim në marrëveshjet e kujdestarisë të urdhëruara në aktgjykimin e divorcit. Ajo pretendoi se gjykata kishin vepruar në favor të tij për shkak të marrëdhënies së saj me një grua tjetër. Duke u mbështetur në nenin 14 në lidhje me nenin 8, parashtruesja u ankua se gjykatat vendase kishin refuzuar t’i jepnin kujdestarinë e fëmijës së saj për shkak të orientimit të saj seksual. Gjykata konstatoi se orientimi seksual i parashtrueses dhe marrëdhënia me një grua tjetër kishte qenë vazhdimisht në qendër të diskutimeve dhe e pranishme në çdo fazë të procedurës gjyqësore. Ajo arriti në përfundimin se kishte pasur një ndryshim në trajtim midis parashtrueses dhe çdo prindi tjetër që dëshiron të ketë kujdestarinë e plotë të fëmijës së tij ose të saj. Ky ndryshim ishte bazuar në orientimin e saj seksual dhe për këtë arsye përbënte diskriminim.

**\* Hedhja poshtë e padisë civile për shkak të imunitetit juridiksional të Vatikanit nuk ka shkelur Konventën (12/10/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **J.C. dhe të tjerët kundër Belgjikës** (kërkesa nr. 11625/17), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, me shumicë (gjashtë vota për një kundër), **se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (e drejta e qasjes në gjykatë)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti ngriti çështjen e imunitetit të Selisë së Shenjtë nga juridiksioni i gjykatave të brendshme. Ai kishte të bënte veçanërisht me një padi për kompensim të ngritur nga 24 parashtrues kundër Selisë së Shenjtë dhe kundër një numri drejtuesish të Kishës Katolike të Belgjikës dhe shoqatave katolike, duke pretenduar se dëmi ishte shkaktuar nga mënyra strukturore e mangët në të cilën Shteti kishte trajtuar problemin e abuzimit seksual në kishë. Megjithatë, gjykatat belge kishin konstatuar se nuk kishin juridiksion në lidhje me Selinë e Shenjtë, parashtruesit argumentuan se ata ishin privuar nga qasja në gjykatë dhe u mbështetën në nenin 6 paragrafi 1 përpara Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Gjykata konstatoi se hedhja poshtë e procedurës nga gjykatat belge për refuzimin e juridiksionit për të shqyrtuar çështjen e dëmshpërblimit të paraqitur nga parashtruesit e kërkesës kundër Selisë së Shenjtë nuk ishte shmangie nga parimet e njohura përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare në çështjet e imunitetit të shtetit dhe prandaj kufizimi i të drejtës për qasje në gjykatë nuk mund të konsiderohen si joproporcionale me qëllimet e ndjekura legjitime.

**\* Procedura tepër e gjatë në dy raste të ndryshme (12/10/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Bara dhe Kola kundër Shqipërisë** (kërkesa nr. 43391/18 dhe 17766/19), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (e drejta për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe **shkelje të nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive)** në lidhje vetëm me parashtruesin e parë. Rasti kishte të bënte me procedurat para gjykatave vendase në një kohë kur kishin ndodhur reformat në drejtësi. Zgjedhja në postin e rektorit të një universiteti kishte qenë në diskutim në rastin e z. Bara, ndërsa rasti i z. Kola kishte të bënte me gjykimin e tij për vrasje. Gjykata konstatoi në veçanti se, edhe duke marrë parasysh reformat gjyqësore që po ndodhnin në Shqipëri në atë kohë, gjykatat vendase kishin dështuar t’i trajtonin çështjet e parashtruesve me një shpejtësi të mjaftueshme, që do të thotë se procedurat nuk ishin zhvilluar brenda një kohe të arsyeshme. Përveç kësaj, ajo konstatoi se mjeti i ri sipas Kodit të Procedurës Civile, i miratuar në vitin 2017, nuk kishte ndihmuar në përshtetimin e procedurave, duke e lënë parashtruesin e parë pa asnjë mjet juridik në dispozicion për të trajtuar shkeljen e të drejtave të tij sipas nenit 6 paragrafi 1. Megjithatë, Gjykata deklaroi se mjeti i ri juridik është parimisht në përputhje me nenin 13 dhe për këtë arsye duhet të shterohet para se të paraqiten ankesa të ngjashme në Gjykatë.



**\* Dhënia e mbrojtjes së shtuar për kreun e Shtetit me anë të një ligji special për fyerje nuk është në përputhje me Konventën (19/10/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Vedat Şorli kundër Turqisë** (kërkesa nr. 42048/19) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me dënimin e parashtruesit me burgim – me dhënien e vendimit të pezulluar për pesë vjet – për fyerje të Presidentit të Republikës, për shkak të dy postimeve që ai ndau në llogarinë e tij në Facebook. Përmbajtja përfshinte ndër të tjera një karikaturë dhe një fotografi të Presidentit të Republikës shoqëruar me komente satirike dhe kritike në lidhje me të. Aktgjykimi për dënimin e parashtruesit bazohej në nenin 299 të Kodit Penal, i cili i siguronte një nivel më të lartë të mbrojtjes për Presidentin e Republikës se sa për personat tjerë. Gjykata konstatoi veçanërisht si më poshtë.

- Nuk kishte asnjë justifikim në rastin konkret për vendosjen e z. Şorli në ndalim policor dhe paraburgim ose për vendosjen e një sanksioni penal, pavarësisht nga fakti se ishte pezulluar nxjerrja e aktgjyimit, me të cilin shqiptohej dënimi me burg. Një sanksion i tillë, nga vetë natyra e tij, në mënyrë të pashmangshme kishte një efekt ftohës në gatishmërinë e personit në fjalë për të shprehur pikëpamjet e tij/saj mbi çështjet me interes publik, veçanërisht duke pasur parasysh efektet e dënimit.

- Procedura penale e ankumuar, e ngritur sipas nenit 299 të Kodit Penal, kishte qenë në papajtueshmëri me lirinë e shprehjes. Sigurimi i mbrojtjes së shtuar me anë të një ligji të posaçëm për fyerjen, si rregull, nuk do të ishte në përputhje me frymën e Konventës dhe interesin e një shteti për të mbrojtur reputacionin e kreut të shtetit të tij, nuk mund të shërbente si justifikim për t'i siguruar kreut të Shtetit status të privilegjuar ose mbrojtje të posaçme kundrejt të drejtës për të përcjellë informacione dhe opinione në lidhje me të.

- Këto gjetje nënkuptonin se shkelja e të drejtave të z. Şorli sipas nenit 10 të Konventës buronte nga një problem në hartimin dhe zbatimin e nenit 299 të Kodit Penal. Sipas mendimit të Gjykatës, sjellja e ligjit të brendshëm përkatës në pajtim me nenin 10 të Konventës do të përbënte një formë të përshtatshme të korrigjimit duke bërë të mundur t'i jepet fund shkeljes së konstatuar.

**\* Bllokimi i urdhërues nga autoritetet për të trajtuar pandeminë COVID-19 të mos barazohet me arrest shtëpiak (20/05/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **León Madrid kundër Spanjës** (kërkesa nr. 30306/13), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me kërkesën e parashtruesit për të

ndryshuar rendin e mbiemrave me të cilët ishte regjistruar vajza e mitur (e lindur në 2005). Në kohën përkatëse, ligji spanjoll parashikonte që në rast mosmarrëveshjeje midis prindërve, fëmija do të mbante mbiemrin e babait të pasuar nga ai i nënës. Parashtruesi i kërkesës argumentoi se kjo rregullore ishte diskriminuese. Natyra automatike e zbatimit të ligjit në kohën përkatëse – e cila i kishte penguar gjykatat vendase të merrnin parasysh rrethanat e veçanta të rastit në fjalë –, sipas mendimit të Gjykatës, nuk mund të ishte justifikuar në mënyrë të vlefshme sipas Konventës. Ndërsa rregulli që mbiemri i babait duhet të vinte i pari, në rastet kur prindërit nuk pajtohen, mund të rezultonte i nevojshëm në praktikë dhe nuk ishte domosdoshmërisht i papajtueshëm me Konventën, pamundësia për të marrë një derogim kishte qenë tepër e rreptë dhe diskriminuese ndaj grave. Përveç kësaj, ndërkohë që vendosja e mbiemrit atëror së pari mund t'i shërbejë qëllimit të sigurisë juridike, i njëjti qëllim mund të shërbehet duke pasur edhe mbiemrin e nënës në atë pozitë. Prandaj, arsyet e dhëna nga Qeveria nuk kishin qenë mjaftueshëm objektive dhe të arsyeshme për të justifikuar ndryshimin e trajtimit të vendosur ndaj parashtruesit të kërkesës.

**\* Dënimet e përjetshme me mundësinë e vetme të lirimit me kusht pas 40 vitesh burgim janë të papajtueshme me Konventën (28/10/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Bancsók dhe László Magyar (nr. 2) kundër Hungarisë** (kërkesa nr. 52374/15 dhe 53364/15) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues)** i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me shqiptimin e dënimeve të përjetshme me mundësinë e lirimit me kusht vetëm pas 40 vitesh burgim. Gjykata konstatoi se dënime të tilla, në fakt, nuk ofronin ndonjë perspektivë reale të lirimit, dhe për rrjedhojë nuk ishin në përputhje me Konventën.

**\* Polonia duhet të ndërmarrë veprime të shpejta për të zgjidhur mungesën e pavarësisë së Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit (08/11/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Dolińska-Ficek dhe Ozimek kundër Polonisë** (kërkesa nr. 49868/19 dhe 57511/19) Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (e drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me ankesat e ngritura nga dy gjyqtarë se Kolegji i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm dhe Çështjeve Publike të Gjykatës Supreme, e cila kishte vendosur për çështjet në lidhje me ta, nuk kishte qenë një “tribunal i themeluar me ligj” dhe kishte mungesë të paanshmërisë dhe pavarësisë. Ata u ankuan në veçanti se Kolegji i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm dhe Çështjeve Publike,





një nga dy kolegjet e sapo krijuara të Gjykatës Supreme, ishin të përbërë nga gjyqtarë të emëruar nga Presidenti i Polonisë me rekomandimin e Këshillit Kombëtar të Drejtësisë (“the NCJ”), organ kushtetues në Poloni që mbron pavarësinë e gjykatave dhe gjyqtarët dhe që ka qenë objekt polemikash që nga hyrja në fuqi e legjislacionit të ri që parashikon, ndër të tjera, që anëtarët e tij gjyqësorë nuk zgjidhen më nga gjyqtarët, por nga Sejm (dhoma e ulët e Parlamentit). Rasti është një nga 57 kërkesat kundër Polonisë, të parashtruara në 2018-2021, në lidhje me aspekte të ndryshme të riorganizimit të sistemit gjyqësor polak të nisur në 2017. Gjykata theksoi se detyra e saj nuk ishte të vlerësonte legjitimitetin e riorganizimit të gjyqësorit polak në tërësi, por të përcaktonte nëse dhe nëse po si, ndryshimet kishin ndikuar në të drejtat e znj. Dolińska-Ficek dhe z. Ozimek sipas nenit 6 paragrafi 1 të Konventës. Gjykata konstatoi se procedura për emërimin e gjyqtarëve ishte ndikuar në mënyrë të padrejtë nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv. Kjo përbënte një parregullsi thelbësore që ndikoi negativisht në tërë procesin dhe cenoi legjitimitetin e Kolegjit të Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm dhe Çështjeve Publike të Gjykatës Supreme, i cili kishte shqyrtuar çështjet e parashtruesve. Prandaj, Kolegji i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm dhe Çështjeve Publike nuk ishte një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj” sipas kuptimit të Konventës Evropiane. Aktgjykimi i ngjan shumë atij të **Reczkowicz kundër Polonisë** (nr. 43447/19) të korrikut 2021. Megjithatë, në këtë aktgjykim u konstatua një shkelje tjetër e dukshme e ligjit të brendshëm, sepse, “në kundërshtim të hapur ndaj sundimit të ligjit”, Presidenti i Polonisë kreu emërimet gjyqësore, pavarësisht nga një urdher përfundimtar i gjykatës që ndalonte zbatimin e rezolutës së Këshillit Kombëtar të Drejtësisë që rekomandonte gjyqtarët në Kolegjit të Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm dhe Çështjeve Publike. Meqenëse shkelja e të drejtave të parashtruesve filloi me amendamentet në legjislacionin polak, të cilat i privuan gjyqësorit polak të drejtën për të zgjedhur anëtarët gjyqësorë të Këshillit Kombëtar të Drejtësisë dhe i dhanë mundësi ekzekutivit dhe legjislativit të ndërhyjnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në procedurën e emërimit gjyqësor, duke kompromentuar kështu sistematikisht legjitimitetin e një gjykate të përbërë nga gjyqtarë të emëruar në këtë mënyrë, kërkohet një veprim i shpejtë korrigjues nga ana e shtetit polak. Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës, shteti ka një detyrim ligjor sipas nenit 46 të Konventës për të zgjedhur, subjekt i mbikëqyrjes nga Komiteti i Ministrave, masat e përgjithshme dhe/individuale që do të merren në rendin e tij juridik të brendshëm për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe për të korrigjuar situatën. Prandaj, i takon shtetit të Polonisë të nxjerrë përfundimet e nevojshme nga ky vendim dhe të marrë masat e duhura për të zgjidhur problemet në rrënjë të shkeljeve të gjetura nga Gjykata dhe për të parandaluar shkelje të ngjashme që të ndodhin në të ardhmen.

**\* Barra e provës bie mbi autoritetet në kërkesën për dëmshpërblim për vrasjen e të burgosurit të luftës (25/11/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Baljak dhe të tjerët kundër Kroacisë** (kërkesa nr. 41295/19) Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (E drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me hedhjen poshtë nga gjykatat vendase të padisë së parashtruesve për dëmshpërblim kundër Shtetit me arsyetimin se ata nuk kishin dëshmuar se shteti ishte përgjegjës për vdekjen e të afërmit të tyre, pavarësisht faktit se ai ishte arrestuar nga ushtarët kroatë dhe ishte dërguar në një vend të panjohur, ku trupi i tij u gjet vite më vonë në një varr masiv me një plagë me armë zjarri në kokë. Gjykata konstatoi në veçanti se përfundimi i arritur nga gjykatat vendase kur hodhi poshtë padinë ishte qartazi i paarsyeshëm. Gjykatat vendase kishin vendosur një standard të paarritshëm provash për parashtruesit e kërkesës, i cili ishte veçanërisht i papranueshëm për shkak të seriozitetit të akteve në fjalë. Gjykata vlerësoi më tej se ankesa e parashtruesve në lidhje me urdhrin e gjykatave vendase që ata të paguanin shpenzimet e përfaqësimit të Shtetit në procedurën civile ishte e parakohshme dhe e refuzoi si të papranueshme.

**\* Nuk ka shkelje të Konventës në rastin kundër një redaktori për të drejtën për t'u harruar (25/11/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Biancardi kundër Italisë** (kërkesa nr. 77419/16), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri: **se nuk kishte pasur shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me “të drejtën për t'u harruar”. Parashtruesi i kërkesës, një ish-kryeredaktor i një gazete në internet, u gjet përgjegjës në procedurën civile për mbajtjen e një artikulli në faqen e internetit të gazetës së tij që raportonte për një zënkë në një restorant, duke dhënë detaje mbi procedurën penale përkatëse. Gjykatat vunë në dukje në veçanti se parashtruesi kishte dështuar të de-indeksonte etiketat identifikuese të artikullit, që do të thotë se çdokush mund të shkruante në një motor kërkimi emrin e restorantit ose pronarit të tij dhe të kishte qasje në informata të ndjeshme mbi procedurën penale, pavarësisht kërkesës së pronarit që të hiqet artikulli. Gjykata ndau këndvështrimin e Qeverisë se jo vetëm ofruesit e motorëve të kërkimit në internet mund të detyrohen të de-indeksojnë materialet, por edhe administratorët e gazetave ose arkivave gazetareske të qasshme përmes internetit, si parashtruesi i kërkesës. Ajo gjithashtu u pajtua me vendimet e gjykatave vendase se qasja e zgatur dhe e lehtë në informacion mbi procedurën penale në lidhje me pronarin e restorantit kishte shkelur të drejtën e tij për reputacion. Prandaj, nuk ishte shkelur e drejta e



parashtruesit për të dhënë informata sipas Konventës, dhe aq më tepër duke pasur parasysh se në fakt nuk i ishte kërkuar të hiqte artikullin nga interneti. Ky ishte rasti i parë në të cilin Gjykata kishte shqyrtuar nëse përgjegjësia civile e një gazetari për informacionin jo-indeksues të publikuar në internet kishte qenë në përputhje me nenin 10 të Konventës.

**\* Der Standard nuk duhet të ishte detyruar të zbulonte informacionin personal të komentuesve në internet (07/12/2021)**

Në Aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Standard Verlagsgesellschaft mbH kundër Austrisë (nr. 3)** (kërkesa nr. 39378/15), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Rasti kishte të bënte me urdhrat e gjykatës që kompania mediatike parashtruese të zbulonte informacionin e regjistrimit të përdoruesve të regjistruar që kishin postuar komente në faqen e saj të internetit, derStandard.at, uebsajti i gazetës Der Standard. Kjo kishte pasuar pas komenteve që pretendohesh se lidhnin politikanët, ndër të tjera, me korrupsionin ose me neo-nazistët, të cilat kompania parashtruese i kishte hequr, megjithëse kishte refuzuar të zbulonte informacionin e komentuesve. Gjykata konstatoi në veçanti se të dhënat e përdoruesit nuk gëzonin mbrojtjen e “burimeve gazetareske”, dhe nuk kishte të drejtë absolute për anonimitetin në internet. Megjithatë, gjykatat vendase nuk kishin balancuar as interesat e paditësve me interesat e kompanisë parashtruese për të mbajtur anonimë përdoruesit e saj në mënyrë që të ndihmonte në promovimin e shkëmbimit të lirë të ideve dhe informacionit të garantuara me nenin 10. Prandaj, urdhrat e gjykatës nuk kishin qenë të nevojshme në një shoqëri demokratike.

(Për më shumë hollësi vizitoni faqen e internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: [www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int))



# INFORMATA PËR GJYKATËN

---

## Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që nga funksionalizimi i saj më 2009, është e vendosur në ish-objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që ndodhet në qendër të Prishtinës, në lagjen “Pejton”. Ky lokacion i Gjykatës, në qendër të kryeqytetit, është simbol i qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve dhe të palëve të tjera të autorizuar në drejtësinë kushtetuese. Ky objekt ndër vite është përshtatur për nevojat dhe për natyrën e punës së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është bërë me ndihmën e donatorëve, siç është rasti me ndërtimin e sallës së gjykimeve, që është financuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2010, themelimin e Bibliotekës së Gjykatës, e cila u mbështet në tërësi nga projekti i GIZ-it për Reformë Ligjore, si dhe sigurimi i zyrave shtesë (kontejnerë), donacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2011.

Objekti i Gjykatës ka gjithsej 1 937 m<sup>2</sup> hapësirë të shfrytëzueshme për punë, që shfrytëzohet nga 65 punonjës.



## ADRESA

Rruga: “Perandori Justinian”, nr. 44, 10 000 - Prishtinë

Tel: +383 (0)38 60 61 62

Mob: +383 (0)45 200 595; +383 (0)45 200 576

Fax: +383 (0)38 60 61 70

E-mail: [gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org](mailto:gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org)

Ueb: [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org)